

FKK 2021

FEDERATA E KARATESË E KOSOVËS

KOSOVA KARATE FEDERATION



RREGULLOREN PËR ORGANIZIMIN TEKNIK TË  
GARAVE

Prishtinë, 2021

*Rregullore për organizimin teknik të garave të FKK-së*

## I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

### Neni 1

Me këtë rregullore rregullohet mënyra e organizimit të garave zyrtare rajonale, shtetërore, mbarëkombëtare dhe ndërkombëtare, të cilat mbahen në teritorin e Kosovës.

### Neni 2

1. Vendimin për organizatorin teknik të një gare e merr Bordi i FKK-se në bazë të propozimit të Komisionit të garave të Federatës së Karatesë së Kosovës.
2. Organizmin teknik të garave vendore Bordi i FKK-së mund t'ia besojë ndonjë klubi me përkrahje të Bordit të FKK-së dhe Komisionit të garave.
3. Organizmin teknik të kampionateve dhe garave shtetërore e organizon Komisioni i garave me miratim të Bordit të FKK-së pas aprovimit të kalendarit të garave.
4. Komisioni i garave, pas miratimit të kalendarit të garave, më së largu deri me 28 shkurt, duhet t'ia propozoj Bordit klubet të cilat do të jenë organizatore teknike të garave të parapara me kalendarin e garave.
5. Të drejtën e pjesëmarrjes në garat zyrtare të FKK-së e kanë të gjitha klubet e regjistruara në FKK, që i kanë të kryera obligimet vjetore sipas rregullores për regjistrimin e klubeve dhe garuesve.
6. Në të gjitha garat e FKK-së aplikohen rregullat e garave sipas rregullores së garave të WKF-it.
7. Komisioni i garave mund dhe është kompetent të organizoj gara të niveleve ndërkombëtare sipas kalendarit zyrtar të FKK-së dhe WKF-së.
8. Në Republikën e Kosovës mund të organizohen gara ndërkombëtarë bazuar në kalendarin zyrtar të federatave përkatëse WKF dhe EKF si dhe gara te niveleve rajonale.

### Neni 3

1. Organizimin e garave ndërkombetare në Kosovë e bëjnë Komisioni i garave dhe Këshilli organizativ i garës, të cilin e emëron Bordi i Federatës së Karatesë së Kosovës.
2. Komisioni i garave, në bashkepunim me Këshillin organizativ të garës nderkombetare, mund t'ia besojë sigurinë dhe anën teknike të garës një klubi nga qyteti ku është vendosur të mbahet gara ndërkombëtare.
3. Në rast se garat ndërkombëtare të WKF/EKF, BKF, MKF mbahen në territorin e Republikës së Kosovës, përgjegjës për organizim teknik të garës do të jetë Bordi i FKK-së, Këshilli Orgnizativ i Garës dhe Komisioni i Garave të FKK-së.

## II. KOMISIONI I GARAVE

### Neni 4

1. Komisionin e Garave dhe Kryesuesin (në vazhdim: Komesari i Garave), do ta miratojë Bordi Ekzekutiv i FKK-së. Komesari i Garave do të përzgjedhet me konkurs të shpallur nga FKK-ja. Komisioni i garave do të ketë tre anëtarë të komisionit.

2. Komesari i Garave do të caktojë dhe propozojë Bordit edhe dy anëtarë të tjerë të komisionit në afat prej 15 ditësh nga emërimi i tij.
3. Në rast të mosmiratimit të ndonjërit të anëtarëve nga ana e Bordit të FKK-së, Komesari duhet të dërgojë emrin/a tjetër për miratim.
4. Komesari i garave në bashkëpunim me komisionin e garave do të angazhojë staf tjetër mbështetës sipas nevojës për garë të caktuar.
5. Bordi Ekzekutiv i FKK-së në rast të dështimit të përmbushjes së detyrave të përcaktuara me këtë rregullore, mund të shkarkojë Komesarin e garave.

#### Neni 5

#### Kushtet e përzgjedhjes së Komesarit të Garave

Komesari i garave do të përzgjedhet nga Bordi Ekzekutiv i FKK-së pas aplikimit për Komesarë të Garave. Bordi Ekzekutiv do të shqyrtojë aplikacionet të cilat duhet të përmbajnë:

- CV-në
- Planin Vjetor dhe Planin e Veprimit për periudhën 1-4 vjeçare.
- Duhet të jetë me përvojë organizative të garave të karatesë të niveleve të ndryshme.
- Duhet të jetë plotësisht i familjarizuar me rregullat dhe zhvillimet e karatesë, vendore dhe ndërkombëtare.
- Preferohet njohja e një nga gjuhët zyrtare të WKF-it.

### III. DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E KOMISIONIT

#### Neni 6

1. Komisioni i garave ka për detyrë që të përpilojë kalendarin vjetor të garave dhe t'ia propozojë Bordit të FKK-së për miratim.
2. Komisioni i garave do t'i dërgojë propozicionet e garave Bordit të FKK-së për miratim.
3. Komisioni i garave ka për detyrë që pas pranimit të kërësive për organizim të garave nga klubet, të bëjë kategorizimin e tyre bazuar në kushtet e organizimit të garës sipas kësaj rregulloreje. Kategorizimi në fjalë do të miratohet nga Bordi i FKK-së.
4. Komisioni i garave do të caktojë numrin e stafit mbështetës për një garë të caktuar duke përfshirë, mjetet logjistikë për mbarvajtje të garës.
5. Komisioni i garave është përgjegjës për hudhjen e shortit dhe matjen e garuesve.
6. Komisioni i garave është përgjegjës për sigurim të ushqimit dhe pijeve për stafin mbështetës, referët dhe stafin mjekësor.
7. Me rastin e përzgjedhjes së organizatorit teknik të garës, Komisioni i Garave do të kujdeset që organizimi teknik i garave të përcaktuara me kalendarin vjetor të shtrihet mbi të gjitha klubet, ose mbi të gjitha rajonet njëtrajtësisht.
8. Komisioni i garave do të kujdeset që pjesëmarrësit me aftësi të kufizuar të kenë qasje të papenguar në sallë dhe tatami.
9. Komisioni i garave do të kujdest që gara të fillojë sipas orarit të parapërcaktuar.
10. Komisioni i garave është përgjegjës për mbajtjen e rendit dhe mbarëvajtjen e garës. Komisioni do të merr masat si në vijim:

- a) Të njoftojë policinë për mbajtjen e garës;
- b) Të njoftojë shërbim mjekësor për autoambulantë;
- c) Të sigurojë sigurim të brendshëm dhe të jashtëm për garë;
- d) Të krijoj skemën organizative (vendosja dhe rregullimi i brendshëm) të garës;
- e) Bëjë kontrollimin dhe verifikimin e akreditimeve të garuesve dhe trajnerëve;
- f) Të kryej pagesat e nevojshme për pjesëmarrje në garë;
- g) Të bëjnë printimin e diplomave dhe mirënjohjeve si dhe të shpërndajnë ato dhe medaljet;
- h) Të sigurojë që tatami është vendos sipas rregullave të WKF-së;
- i) Të sigurojë që pajisjet për garë, monitorat, TV-t, lloptopët, printeri, kamerat, tabletat, flamujt, tavolinat, karrikat, ndriqimi, zërimi, piadestali për ndarje të medaljeve, janë sipas normave të organizimit të garës dhe janë të vendosura në sallë;
- j) Të shpërndaj shortin ekipeve pjesëmarrëse;
- k) Të sigurojë kopje fizike të ankesës zyrtare dhe të njëjtat t'ia dorëzojë gjyqëtarit suprem;
- l) Të sigurojë vendin për zyrtarë me tavolina dhe karrika të mjaftueshme (sipas garës);
- m) Të sigurojë që temperatura në sallë nuk është më e ultë se 18°C dhe ndriqimi të jetë në mes të 120 -140 luksë;
- n) Është përgjegjës për hapje dhe mbyllje zyrtare të garës;
- o) Të sigurojë që në rast të organizimit teknik të garës nga klubet, ato t'i përmbushin të gjitha kriteret e përcaktuara me këtë rregullore.

## Neni 7

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komesarit:

- a) Për realizimin dhe përmbushjen e detyrave sipas kësaj rregulloreje, Komesari do të harojë një plan vejtore të punës së komisionit dhe kërkesat logjistike në FKK;
- b) Komesari i garës do të jetë përgjegjës për realizimin dhe zbatimin e të gjitha detyrave që realizon komisioni i garave. Është përgjegjës për delegim dhe caktim të detyrave tjera/shtesë stafit mbështetës dhe detyrave tjera që nuk janë të përfshira në këtë rregullore por që ndikojnë në zhvillimin dhe organizimin e mirëfillt të garës.
- c) Komesari i garës për punën e vet dhe të komisionit i raporton Bordit Ekzekutiv të FKK-së.
- d) Komesari i garës do të prodhojë një raport vjetor si dhe pas secilës garë, jo më vonë se 10 ditë, të dërgojë raportin e garës në administratën e FKK-së;
- e) Komesari është përgjegjës për thirrjen dhe organizimit të mbledhjeve të komisionit. Vendimet në mbledhje merren me shumicë votash, por, në rast të mungesës së njërit nga anëtarët, vota e Komesarit do të jetë mbizotëruese në vendimmarrje;
- f) Komesari delegon detyra tek anëtarët e komisionit sipas nevojës;
- g) Për punën e vet dhe të stafit, komisioni dhe komesari do të kompensohen sipas tarifave të përcaktuara nga Bordi Ekzekutiv i FKK-së

### Neni 8

Detyrat e anëtarëve të komisionit:

- a) Anëtarët tjerë të komisionit të garave do të marrin pjesë në mbledhje të komisionit të garave, do të propozojnë, harmonizojnë dhe ndihmojnë në shkrimin e planeve dhe raporteve të punës.
- b) Ata/o do t'i asistojnë komesarit në kryrjen e detyrave sipas kësaj rregulloreje dhe do të pranojnë detyra të deleguara nga Komesarit.
- c) Ata/o marrin pjesë në të gjitha organizimet e garave. Në mungesë të Komesarit, njëri nga ata/o do të zëvendësojë Komesarin në garë.

### Neni 9

Stafi mbështetës i komisionit të garave:

- Sigurimi fizik në sallë;
- Kohëmatësit;
- Asistentët e shortit;
- Administratorët e listave të shortit dhe verifikues të akreditimave;
- Folësi;
- Administratori i pagesave;
- Shkruesi i diplomave dhe mirënjohjeve
- Shpërndarësi i medaljeve;
- IT-ja
- Fotografi zyrtarë
- Vullnetarë tjerë sipas nevojës.

## IV. KRITERET PËR PËRCAKTIMIN E ORGANIZATORIT TEKNIK

### Neni 10

1. Komisioni i garave do të verifikoj në vend (në lokacion) kushtet teknike pas pranimit të kërkesës për organizim të garës dhe do t'i propozojë Bordit FKK-së për lejimin apo mos lejimin e mbajtjes së garës.
2. Në rast të mospërbushjes së kushteve të parapara sipas kësaj rregulloreje, organizatorit teknik do t'i refuzohet kërkesa për organizim të garës.
3. Për të marr organizimin teknik të garës, klubi që aplikon për organizim duhet të plotësojë kushtet në vijim:

- a) Të sigurojë objektin në të cilin mund të vendosen së paku 3 (tre) tatami,
- b) Hapsira e përgjithshme e sallës duhet të jetë së paku 50x35 metra,
- c) Madhësia e secilit tatami duhet të jetë 8x8 metra duke përfshi zonën e sigurisë 12x12 m për një tatami, sipas WKF,
- d) Tatamit duhet të jenë të aprovuar nga WKF për gara zyrtare,
- e) Tribuna të ndara nga hapësira garuese me kapacitet prej së paku 1000 vende për shikues,
- f) Të sigurohen vende të mjaftueshëm për VIP, trajner, refer dhe garues,

- g) Të sigurojë mbajtjen e rendit dhe ndërmarrë masa parandaluese me praninë e obligueshme të policisë gjatë tërë kohës së garës, në mënyrë që të sigurohet zhvillimi i papenguar i sajë;
- h) Të sigurojë numër të mjaftueshëm të stafit mbështetës që do t'i kërkojë Komisioni i Garave sipas rregullores së garave të FKK-së,
- i) Me pano reklamuese ose ndonjë mënyrë tjetër të përshtatshme t'i ndajë tatamit nga hapsirat e garuesve dhe personave zyrtar të garës,
- j) Siguria dhe rendi të bëhet sipas Rregullores së FKK-së për Siguri,
- k) Të zbatojë Rregulloren për Shëndetësi (autoambulanca),
- l) Të sigurojë zërimin e sallës dhe në kuadër të kësajë, flamurin dhe himnin e Kosovës, muzikën përkatëse (marshe) dhe fanfarat,
- m) Që në vend të dukshëm ta vendosin përveq flamurit shtetëror dhe atë kombëtar edhe flamurin e FKK-së,
- n) Të sigurojë pajisjet e domosdoshme teknike:
  1. laptop, LCD – monitor për rezultate,
  2. kronometër, procesverbalet,
  3. flamuj për gjyqtarë, të kuq dhe të kaltër (së paku një palë flamuj rezervë),
  4. tavolina dhe karrike për të gjithë personat zyrtarë dhe për gjyqtarë,
  5. karrika për garuesit për pjesëmarrje ekipore dhe pedestalin për ceremoninë e shpalljes së fituesve,
  6. të sigurojë karrike për personat zyrtarë të FKK-së dhe për mysafirë.

#### **Neni 11**

Përveç tjerash, organizatori teknik i garave vendore, inkurajohet që:

- a. Të organizoj dhe të zbatoj propagandën përkatëse nëpërmjet ftesave, pllakatave, mjeteve të informimit masiv dhe mënyra të tjera të përshtatshme lidhur me garën që ju ka besuar.

#### **Neni 12**

Garat mund të mbahen në sallat sportive që plotësojnë minimumin e kushteve teknike dhe të temperaturës krahas kushteve të parapara me nenin 10 të kësaj Rregulloreje për garat rajonale, shtetërore dhe ndërkombëtare, sipas Rregullores së Garave të FKK-së.

#### **Neni 13**

Për shkak të popullarizimit dhe masovizimit të sportit të karatesë në vend, garat e nivelit rajonal mund të mbahen edhe në salla më të vogla, të cilat plotësojnë minimumin e kushteve nga neni 10 i kësaj Rregulloreje, në të cilën mund të organizohen dy tatami dhe të vendosen 100 – 200 shikues.

## **V. OBLIGIMET E ORGANIZATORIT TEKNIK**

#### Neni 14

Organizatori teknik është i obliguar që në garë për secilin tatami të sigurojë:

- a) Dy tavolina (2) të mëdha dhe karrika të mjaftueshme sipas nivelit të garës,
- b) Material të përshtatshëm për të shkruar,
- c) Një karrikë, një flamur të kuq për KANSA,
- d) 5 flamuj të kaltërt dhe 5 flamuj të kuq për gjyqtarë,
- e) Së paku 1 palë flamuj rezervë të kaltërt dhe të kuq,
- f) Kyqje në rrymë elektrike për së paku 3 pajisje elektronike,
- g) Së paku dy (2) LCD ose plazma ekrane moderne / monitor të kyqur në rrymë me këto kushte:
  1. Madhësia diagonale së paku 32 " ose më shumë
  2. PC video input ( D – Sub Jack/ pin -> VGA )
  3. PC audio input konektor për kufje
  4. Kamerat për VR,
  5. Tableta për gjyqtarë,
  6. Peshore,
  7. Kabllo vazhduese,

#### Neni 15

1. Organizatori është i obliguar që të sigurojë një hapësirë të përshtatshme për nevojat e Komisionit, ku do të bëhet kontrollimi i dokumenteve, pagesave, etj.
2. Dy hapësira për matje, femra dhe meshkuj,
3. Hapësirë për nxemje të garuesve me tatami,
4. Hudhja e shortit bëhet në zyrat e FKK-së ose organizatori teknik duhet të sigurojë një hapësirë të përshtatshme. Shorti bëhet nën mbikçyrjen e Komisionit të garave. Çdo ndryshim në lista kryesore duhet të nënshkruhet nga komesari i garës ose personi i autorizuar,
5. Për short do të shfrytëzohet softveri i cili është i aprovuar nga WKF,
6. Pas përfundimit të shortit dhe nënshkrimit nga komesari, shorti shpërndahet tek të gjitha klubet pjesëmarrëse përmes postës elektronike.

#### Neni 16

Federata e Karatesë ose organizatori teknik është i obliguar që të sigurojë mjete të nevojshme financiare për pagesën e shpenzimeve të udhëtimit, mëditjeve dhe taksave zyrtare për të gjithë personat zyrtarë (komisionin e garave, stafin administrativ, gjyqtarët etj).

#### Neni 17

Kur organizimi teknik i garave iu ka besue një klubi, të ardhurat e realizuara nga kotizimet, donacionet, reklamat dhe propaganda, si dhe sponzorizimi, pas pagesës së të gjitha shpenzimeve të garës, do të ndahen në mes të organizatorit teknik dhe Federatës së Karatesë sipas numrit pjesëmarrës të garuesve, nga një (1) euro për garues. Kjo pagesë duhet të bëhet në llogari të FKK-së brenda 7 ditëve.

### Neni 18

1. Komisioni i Garave i FKK-së para çdo gare do të bëjë kontrollimin e sallës, pajisjeve dhe mjeteve ndihmëse të nevojshme.
2. Nëse Komisioni i Garave konstaton lëshime të caktuara, do ta urdhëroj organizatorin teknik që ti eliminoj, duke respektuar orarin e garës.

### Neni 19

Kundër organizatorit teknik i cili nuk i ka siguruar kushtet e domosdoshme për zhvillimin e papenguar të garës që ju ka besuar, Komesari i garës dhe Komisioni i Garave janë të obliguar të inicojnë procedure disiplinore.

### Neni 20

1. Organizatori teknik është i obliguar që me shërbimin e kujdestarëve, personave zyrtarë dhe garuesve në arenë t'ju siguroj zhvillimin normal të garës sipas rregullores.
2. Pranë tavolinës së procesmbajtësve mund të qëndrojnë vetëm personat zyrtar si vijon:
  - a) Komesari i Garës,
  - b) Udhëheqësi teknik i garës,
  - c) Gjyqtari suprem,
  - d) Procesmbajtësit (nga një për çdo arenë dhe procesmbajtësi kryesor) dhe
  - e) Folësi.
3. Në hapsirën për garues dhe në hapsirën zyrtare për zhvillimin e garës, përveq gjyqtarëve mund të hyjnë vetëm garuesit e ftuar që të marrin pjesë si dhe trajnerët e me pajisje të caktuara dhe akreditime.
4. Në zonën e përcaktuar për garues mund të hyjnë vetëm personat me akreditim.
5. Për punë teknike, varësisht prej llojit dhe rëndësisë së garës përcaktohet edhe numri i personave përkrahës.

## VI. KATEGORIZIMI I GARAVE

### Neni 21

Sipas Nenit 6 pika 6.3, Komisioni i Garave do të bëjë kategorizimin e garave. Kategorizimi i garave nënkupton ndarjen e nivelit teknik të organizimit. Do të jenë tri kategori: A, B dhe C.

### Neni 22

Kategoria A e garës:

1. Çdo garë e cila organizohet në menaxhim të Bordit Ekzekutiv dhe Komisionit të Garave të FKK-së, sikurse janë kampionatet, turnet e organizuara nga FKK, mbarëkombëtarë dhe garat tjera të cilat Komisioni i garave është i autorizuar t'i organizojë sipas kësaj kategorie.
2. Gara e tillë duhet të plotësoj të gjitha kushtet e përmendura në Nenin 10 të kësaj rregulloreje.



### Neni 23

Kategoria B e garës:

1. Çdo garë që organizmi teknik i është ndarë, sipas aplikimt paraprak, klubit që i ka plotësuar pjesërisht kushtet sipas Nenit 10.

### Neni 24

Kategoria C e garës:

1. Çdo garë që organizmi teknik i është ndarë, sipas aplikimt paraprak, klubit që i ka plotësuar kushtet sipas Nenit 13.

### Neni 25

Ndarja e vlerës së pikëve për secilën kategori të garës do të përcaktohet në Rregulloren për Përzgjedhjen e Sportistëve, Trajnerëve dhe Punëtorve Sportiv të vitit.

## VII. AKREDITIMET

### Neni 26

1. Akreditimet e FKK-së janë dokumente zyrtare të lëshuara nga FKK për garues, trajner, gjyqëtarë dhe stafin tjetër administrativ dhe mbështetës.
2. Akreditimet duhet të përmbajnë:
  - Emrin dhe mbiemrin e bartësit
  - Pozita/detyra/cilësia
  - Fotografia e bartësit
  - Emri i klubit
  - Data e lëshimit dhe skadimit
  - Emblemën e FKK-së
  - Vulën e FKK-së dhe nënshkrimin e personit zyrtarë.
3. Akreditimi mund të revokohet në rast të keqpërdorimit dhe rasti i kalon Komisionit Disiplinor.

## VIII. PROTOKOLI I HAPJES DHE I SHPALLJES SË REZULTATEVE

### Neni 27

Në garat e nivelit shtetëror dhe ndërkombëtar, para fillimit të dueleve, organizatori teknik është i obliguar që për defileun solemn, prezantimin e pjesëmarrësve, garuesve, ekipeve dhe gjyqtarëve, të sigurojë muzikën përkatëse, flamujt dhe himnin shtetëror.

### Neni 28

1. Për ceremoninë solemne të shpalljes së rezultateve dhe fituesve, organizatori teknik është i obliguar të sigurojë piedestalin për shpalljen e fituesve dhe fanfarat.

FKK 2021

2. Nëse gara është e nivelit ndërkombëtar, organizatori është i obliguar që në bashkëpunim me ekipet mysafire të sigurojë nga dy flamuj dhe himnet kombëtare për të gjithë pjesëmarrësit.

## IX. DISPOZITAT E PËRFUNDIMTARE

### Neni 29

1. Për aplikimin e dispozitave të kësaj rregulloreje përkujdeset Bordi Ekzekutiv dhe Komisioni i Garave i FKK-së.
2. Organizatori teknik që nuk do t'i përmbahet kushteve të përcaktuara me këtë Rregullore dhe që do të bëjë lëshime gjatë mbajtjes së rendit dhe sigurisë në garë që ka ndikuar në uljen e cilësisë së garës, Komesari i garës dhe Komisioni i Garave janë të obliguar të parashtrajnë paraqitje dicipline.

### Neni 30

Masa disiplinore e shqiptuar nga Komisioni Disiplinor do të jetë përcaktuese për dhënjën apo refuzimin e mbajtjes së garës tjetër nga ai klub.

### Neni 31

Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj rregulloreje do të bëhen në mënyrën dhe procedurën të njëjtë si miratimi i saj.

### Neni 32


Rregullorja e Garave ka edhe Shtojcën me propozicione të garave për të gjitha kategoritë dhe grupmoshat, kata dhe kumite.

### Neni 33

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Bordi i Federatës së Karatesë së Kosovës, ndërsa do të fillojë të aplikohet nga data e nënshkrimit të saj.

Prishtinë, 19 qershor 2021

Ismet Krasniqi



Kryetar